

Vaksina për koronavirusin

– Comirnaty (Pfizer dhe BioNTech)

Informacion kur ju është ofruar kjo vaksinë

Koronavirusi i ri shkakton infeksion në aparatit e frymëmarrjes. Shumë njerëz përjetojnë simptoma të lehta ose nuk kanë fare simptoma, por disa mund të sëmuren rëndë. Të moshuarit dhe ata që kanë tashmë sëmundje të tjera të caktuara, janë më të rrezikuar të sëmuren rëndë ose të vdesin. Vaksina për koronavirusin parandalon sëmundjen COVID-19. Synimi kryesor është të mbrojë jetën dhe shëndetin.

Kush duhet ta bëjë vaksinën për koronavirusin?

Vaksinat për koronavirusin që jepen nëpërmjet programit kombëtar të vaksinimit, janë në dispozicion për njerëzit që jetojnë në Norvegji. Vaksina është falas dhe me dëshirë.

Si ta marr vaksinën?

Vizitoni rregullisht faqen e internetit të komunës suaj për informacion se kujt do t'i jepet vaksina, si do të organizohet vaksinimi dhe kur do të bëhet.

Si jepet vaksina?

Vaksina injektohet në pjesën e sipërme të krahut. Para se të bëni vaksinën, do të pyeteni nëse ndiheni mirë dhe nëse më përpara keni pasur reaksione ndaj vaksinave. Mos harroni të tregoni nëse keni qenë me COVID-19 ose nëse keni bërë vaksinë për koronavirus më përpara, si dhe nëse jeni shtatzënë, keni alergji, përdorni ilaçe ose keni probleme të tjera shëndetësore. Ndiqni udhëzimet për numrin e dozave dhe intervalet që zbatohen për grupin tuaj. Qendra e vaksinimit mund t'ju ndihmojë për këtë. Është e rëndësishme që t'i merrni dozat në ditët e caktuara. Ndodh shpesh që vaksinimi të shtyhet në rastet e sëmundjeve akute dhe kur personi ka temperaturë mbi 38 °C. Pasi të keni bërë vaksinën, do t'ju kërkohet të prisni të paktën 20 minuta.

Si funksionon kjo vaksinë?

Vaksina përmban recetën (RNA mesazhiere) për kunjat në koronavirus. Trupi krijon kopje të padëmshme të këtyre kunjave, me të cilat sistemi imunitar mund të praktikohet. Në këtë mënyrë, sistemi imunitar mëson t'i njohë kunjat e koronavirusit dhe ta mbrojë trupin nëse infektohet me virusin. RNA mesazhiere eliminohet shpejt nga trupi dhe ajo nuk ka efekt në materialin gjenetik.

Vaksina nuk përmban virus dhe nuk shkakton sëmundjen COVID-19. Vaksina e koronavirusit vepron për të parandaluar sëmundjen. Nuk mund ta shërojë sëmundjen nëse ka filluar tashmë.

Kjo metodë e prodhimit të vaksinave nuk është përdorur më parë për sëmundjet infektive të njerëzit, por teknologjia njihet dhe përdoret në trajtimin e kancerit.

Sa e efektshme është kjo vaksinë?

Vaksina ju mbron nga sëmundja që shkaktohet nga koronavirusi i ri. Shkalla e mbrojtjes nga sëmundja e rëndë është e lartë si pas dozës së parë, ashtu dhe pas dozës së dytë. Për të pasur mbrojtje të mirë nga *infektimi* me koronavirus, nevojiten dy doza. Ende nuk e dimë për sa kohë zgjat mbrojtja. Nëse mbrojtja bie me kalimin e kohës, mund të jetë e nevojshme të bëhet një dozë përforcuese. Vaksinat nuk mbrojnë plotësisht nga përhapja e mëtejshme e infeksionit. Prandaj, është e rëndësishme që të zbatoni këshillat aktuale për parandalimin e përhapjes së infeksionit..

Efektet anësore

Shumica e efekteve anësore ndodhin brenda pak ditëve të para pas vaksinimit. Vaksinat për koronavirusin japin efekte anësore më shpesh sesa vaksinat e tjera. Zakonisht, simptomat janë të lehta ose mesatare dhe largohen brenda pak ditësh. Megjithatë, disa kanë simptoma më të rënda. Shpesh, të rinjtë kanë efekte anësore pak më të rënda se të rriturit.

Shumica e personave të vaksinuar kanë dhimbje në vendin e injektimit. Disa nga efektet anësore të shpeshta përfshijnë lodhjen, dhimbjen e kokës, dhimbjet muskulore, ethet, dhimbjet e kyçeve dhe temperatura. Këto efekte anësore janë më të shpeshta pas dozës 2.

Efektet anësore të rënda janë të rralla. Disa prej efekteve anësore të rënda janë inflamacioni i zemrës (miokardi dhe perikardi). Zakonisht këto ndodhin pas dozës 2 dhe më shpesh ndodhin te adoleshentët dhe të rriturit. Efektet anësore të rralla, si reaksionet e rënda alergjike dhe inflamacioni i zemrës mund të trajtohen. Nuk mund të përjashtojmë këtu efektet anësore që ndodhin rrallë ose efektet anësore që shfaqen shumë kohë pas vaksinimit.

Çfarë të bëj nëse kam efekte anësore?

Nëse ju shfaqen efekte anësore të papritura, të rënda ose që zgjatin shumë, kontaktoni mjekun ose një punonjës të shëndetësisë për kontroll dhe këshilla. Kjo vlen pavarësisht nëse besoni që kjo ju vjen prej vaksinës ose jo. Punonjësit e kujdesit shëndetësor kanë detyrimin të raportojnë çdo reaksion të rëndë dhe të papritur që dyshojnë se vjen për shkak të një vaksine. Gjithashtu mund të dërgoni vetë një njoftim nëpërmjet helsenorge.no.

Aprovimi me kushte

Kjo vaksinë koronavirusi është testuar në studime të mëdha, ku mijëra njerëz e kanë marrë vaksinën. Studimet janë bërë njëloj si për vaksinat e tjera, por koha e studimit është më e shkurtër. Autoritetet rregullatore për medikamentet i kanë dhënë vaksinës një aprovim me kushte. Kjo do të thotë se ka të dhëna të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se dobitë që sjell vaksina janë më të mëdha se rreziqet që sjell ajo, por që prodhuesi i vaksinës duhet t'i vazhdojë studimet dhe t'u japë vazhdimisht të dhëna autoriteteve rregullatore të medikamenteve kur të jenë të disponueshme.

Cilën vaksinë kam bërë?

Kur të merrni vaksinën për koronavirusin, kjo do të regjistrohet në Regjistrin Norvegjez të Imunizimit, SYSVAK. Mund të shihni informacionet tuaja në helsenorge.no.

A doni të dini më shumë?

Ju lutemi pyesni mjekun ose punonjësin e shëndetësisë, ose vizitoni faqen e internetit të Institutit Norvegjez të Shëndetësisë në fhi.no/cip.